

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
 MINISTRIA E ARSIMIT  
 DHE SPORTIT  
 QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

## MODEL TESTI I MATURËS SHTETËRORE 2023

### LËNDA: HISTORI

Udhëzime për maturantin/kandidatin

Testi përmban gjithsej **60 pikë**.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Testi ka **20 pyetje me zgjedhje (alternativa)** dhe pyetjet e tjera janë me zhvillim.

Pikët për secilën pyetje janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7	8
Pikët								
Kërkesa	9	10	11	12	13	14	15	16
Pikët								
Kërkesa	17	18	19	20	21	22	23	24
Pikët								
Kërkesa	25	26	27	28	29	30	31	32
Pikët								
Kërkesa	33	34	35					
Pikët								

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

1. Cili fisi ilir shtrihej në territorin e Kosovës së sotme? 1 pikë
- A) Amantët.  
B) Dardanët.  
C) Desaretët.  
D) Taulantët.
2. Konflikti midis Spartës dhe Athinës njihet në histori me emrin: 1 pikë
- A) Lufta e Peloponezit.  
B) Lufta e Mikenës.  
C) Lufta e Athinës.  
D) Lufta Perse.
3. Pas rënies së Perandorisë Romake, pjesa lindore e saj u quajt Perandoria: 1 pikë
- A) Perse  
B) Bizantine  
C) Mongole  
D) Osmane
4. Cili nga dokumentet e mëposhtëm vendosi parimin e monarkisë së kufizuar në Angli? 1 pikë
- A) 12 Tabelat.  
B) Magna Karta.  
C) Akti i Supremacisë.  
D) Deklarata e Pavarësisë.
5. Në shek. XII formacioni shqiptar i cili mori tipare të qarta shtetërore ishte principata e: 1 pikë
- A) Zenebishëve.  
B) Muzakajve.  
C) Topiajve.  
D) Arbrit.
6. Një nga shtetet evropiane që bëri shpenzime të mëdha në interes të zbulimeve gjeografike ishte: 1 pikë
- A) Portugalia.  
B) Gjermania.  
C) Franca.  
D) Anglia.
7. Ndarja e të krishterëve në katolikë e protestantë ishte një nga rrjedhojat e: 1 pikë
- A) ndarjes së Perandorisë Romake.  
B) zbulimeve gjeografike.  
C) Koncilit të Trentos.  
D) Reformacionit.

8. Cili nga shtetet evropiane u bë atdheu i Revolucionit të Parë Industrial? **1 pikë**
- A) Gjermania.  
 B) Franca.  
 C) Anglia.  
 D) Italia.
9. Shteti i Skënderbeut ishte i organizuar në formën e: **1 pikë**
- A) Republikës.  
 B) Republikës parlamentare.  
 C) Monarkisë parlamentare.  
 D) Monarkisë feudale.
10. Shkolla e parë shqipe u hap në vitin 1887 në qytetin e: **1 pikë**
- A) Elbasanit.  
 B) Shkodrës.  
 C) Korçës.  
 D) Vlorës.
11. Kushtet e rënda të Traktatit të Versajës ndaj Gjermanisë në pikëpamje politike u shfrytëzuan më shumë nga: **1 pikë**
- A) borgjezia dhe tregtarët.  
 B) fshatarët dhe klasa punëtore.  
 C) Partia Naziste.  
 D) Partia Kristian Demokrate.
12. Rënia e perandorisë Osmane dhe asaj Austro – hungareze ndikoi drejtpërsëdrejti në: **1 pikë**
- A) përhapjen e komunizmit.  
 B) krijimin e shteteve të reja.  
 C) zbatimin e Planit Marshall.  
 D) krijimin e Lidhjes së Kombeve.
13. Një nga tiparet karakteristike të diktaturave autoritare është: **1 pikë**
- A) ndalimi i veprimtarive të partive të tjera politike.  
 B) nxitja e veprimtarisë së sindikatave.  
 C) liria e shtypit dhe e medias.  
 D) respektimi i lirive të individit.
14. Gjatë Konferencës së Ambasadorëve në Londër, shtetet që mbështetën çështjen shqiptare ishin: **1 pikë**
- A) Austro-Hungaria dhe Gjermania.  
 B) Austro-Hungaria dhe Italia.  
 C) Italia dhe Britania e Madhe.  
 D) Gjermania dhe Franca.

15. Një nga arsytet e krijimit të NATO-s ishte: 1 pikë
- A) për t'ju kundërvënë rrezikut që vinte nga kampi komunist.  
 B) për të shmangur konfliktin midis BS dhe Afganistanit.  
 C) për të kontrolluar tregtinë evropiane.  
 D) për të forcuar qeveritë komuniste.
16. Thelbi i Kursit të Ri të Ruzveltit ishte: 1 pikë
- A) zëvendësimi i plotë i pronës private me atë shtetërore.  
 B) zvogëlimi i rolit të qeverisë në ekonomi.  
 C) rritja e rolit të qeverisë në ekonomi.  
 D) aplikimi i modelit sovjetik në ekonomi.
17. Traktati i Varshavës u krijua në vitin 1955 si kundërpërgjigje për: 1 pikë
- A) shpikjen e bombës me hidrogjen në SHBA.  
 B) fillimin e revolucionit komunist në Kubë.  
 C) ndërhyrjen e SHBA në Kore.  
 D) krijimin e NATO.
18. Sipas Traktatit të Fshehtë të Londrës, shteti i cinguar shqiptar do të vihej nën protektoratin e: 1 pikë
- A) Britanisë së Madhe.  
 B) Austro-Hungarisë.  
 C) Greqisë.  
 D) Italisë.
19. Luajti një rol vendimtar në favor të Shqipërisë gjatë Konferencës së Paqes së Parisit (1919-1920): 1 pikë
- A) David Llojd Xhorxh.  
 B) Vitorio Orlando.  
 C) Zhorzh Klemanso.  
 D) Thomas Udron Uilson.
20. Ndalimi me ligj i fesë në Shqipëri, u vendos në kushtetutën e vitit: 1 pikë
- A) 1914  
 B) 1922  
 C) 1946  
 D) 1976

21. Shpjegoni dy nga të drejtat natyrore të njeriut sipas Xhon Lokut. Cili është roli i qeverisë sipas tij? **3 pikë**

*Shpjegimi:*

---

---

*Roli i qeverisë sipas Xh. Lokut:*

---

22. Cilat ishin tri nga ndryshimet më të mëdha në fushën ekonomike në Evropë që erdhën si pasojë e zbulimeve të mëdha gjeografike. **3 pikë**

---

---

---

---

23. Pse U. Uillson paraqiti planin e tij konkret prej 14 pikash? Identifikoni katër nga pikat e planit të Uillsonit për paqen në botë. **4 pikë**

---

---

---

---

24. Kongresi i Elbasanit u mbajt më 2-8 shtator 1909. Cili ishte vendimi kryesor që u mor aty dhe qëllimi i këtij vendimi? **2 pikë**

*Vendimi:*

---

---

*Qëllimi:*

---

---

25. Princi i zgjedhur nga Fuqitë e Mëdha ishte ushtaraku gjerman Vilhem Von Vid, i cili erdhi në Shqipëri në mars 1914 dhe u largua në muajin shtator të po atij viti. Cilat ishin tre nga arsyet e dështimit të misionit të tij? **3 pikë**

---

---

---

---

*Për t'ju përgjigjur pyetjes 26 dhe 27 referojuni paragrafit të mëposhtëm.*

*“Unë i gjuajta Franc Ferdinandit dy herë nga një distancë prej 4.5 hapash. Ktheva dorën për të bërë vetëvrasje, por disa policë dhe oficerë më kapën. Ata më morën me vete, të mbuluar me gjak për në stacionin e policisë. Unë nuk jam kriminel, por hoqa qafe një njeri të keq. Unë mendova se kjo ishte një gjë e drejtë”.*

Gavrilo Princip

26. Kjo vrasje shërbeu si shkëndijë për fillimin e një prej ngjarjeve më të rëndësishme të shek. XX. Identifikoni ngjarjen në paragrafin e mësipërm. **1 pikë**

---

27. Analizoni dy nga shkaqet e fillimit të ngjarjes së dhënë në paragrafin e mësipërm. **2 pikë**

---

---

---

---

28. Konferenca e Pezës dhe ajo e Mukjes janë dy ngjarjet e rëndësishme të Luftës Nacionalçlirimtare.

- a) Krahasoni Konferencën e Pezës me atë të Mukjes dhe evidentoni një të përbashkët dhe një të veçantë mes tyre. **2 pikë**

---

---

- b) Identifikoni një nga arsyet përse vendimet e Konferencës së Mukjes nuk gjetën zbatim konkret në terren. **1 pikë**

---

---

29. Cilat ishin tre nga arsyet e lidhjes së marrëdhënieve të ngushta të Shqipërisë me Kinën Komuniste. **3 pikë**

---

---

---

---

30. Cilat ishin dy nga rrugët që përdori Bashkimi Sovjetik pas Luftës së Dytë Botërore për rimëkëmbjen ekonomike? **2 pikë**

---

---

---

---

31. Në janar 1925 Asambleja Kushtetuese e shpalli Shqipërinë republikë. Në mars të po këtij viti u miratua Statuti Themeltar i Republikës së Shqipërisë. Kreu i shtetit sipas Statutit ishte Presidenti. Cilat ishin tri nga kompetencat që statuti i njihte kreut të shtetit? **3 pikë**

---

---

---

---

32. Cilat ishin tre nga ndryshimet që ndodhën, pasi Asambleja shpalli "bashkimin personal" të Shqipërisë me Italinë, nën kurorën mbretërore të Viktor Emanuelit III. **3 pikë**

---

---

---

33. Argumentoni pse qeveria e Zogut zgjodhi si partner në politikën e jashtme Italinë?

**2 pikë**

---

---

---

---

34. Në vitet `80 të shek. XX, Shqipëria u përfshi nga një krizë e thellë ekonomike. Identifikoni tre nga shkaqet e kësaj krize ekonomike.

**3 pikë**

---

---

---

---

35. Rënia e kampit komunist në fillim të viteve '90 të shek. XX, u kushtëzua nga disa faktorë. Cilët ishin tre nga këta faktorë që sollën revolucionet demokratike në Evropën Lindore?

**3 pikë**

---

---

---

---